



# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



KA/Nr. 2904/20

Datë: 23/11/2020

Komisioni i Ankesave në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, i themeluar me Vendimin Nr.1448/20D, ta datës 04.09.2020, në përbërje të Faton Merovci, Muhamet Qerimi dhe Krenare Sogojeva Dermaku, në shqyrtimin e lëndës administrative, respektivisht ankesës së Kolegjit të Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli", nr.ref.1282/20H të datës 20.08.2020 kundër Vendimit të KSHC Nr. 983/20D të datës 21.07.2020 për mos akreditim Institucional, e pranuar më 23.10.2020, në mbështetje të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e datës 11.11.2020, me votim unanim, mori këtë:

### VENDIM

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Kolegjit të Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli" nr. Ref.1282/20H e datës 20.08.2020 dhe vërtetohet Vendimi i KSHC-së Nr. 983/20D i datës 21.07.2020.

### ARSYETIM

Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli" më datë 20.08.2020, brenda afatit ligjor ka parashtruar Ankesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, përmes së cilës ka kërkuar që Këshilli Shtetëror i Cilësisë të rishqyrtoj vendimin e tij të datës 21.07.2020, nr. 983/20D, me të cilin nuk është riakredituar në nivel Institucional. Pala me Ankesën e datës 20.08.2020 pretendon se:

Këshilli Shtetëror i Cilësisë pa të drejtë ka refuzuar akreditimin në nivel Institucional duke u bazuar në vlerësim të gabuar të gjendjes faktike dhe juridike.

Më tutje ka atakuar me ankesë Vendimi i KSHC duke kundërshtuar raportin e ekspertëve në standardet e parapara me Manualin e Akreditimit (korrik 2018) si në vijim:

- Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia ndaj publikut;
- Menaxhimi i cilësisë;
- Mësimdhënia dhe mësimdhënia;



- Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse;
- Burimet dhe objektet për mësim-nxënie;
- Bashkëpunimi institucional;

Pala ka pretenduar se këto standarde janë plotësuar, duke paraqitur argumente e veta.

KSHC, pas pranimit të raportit nga ekspertët ka konstatuar se raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit konstaton se nga gjithsej 11 kapituj të standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit, Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike “Tempulli” përmbushë substancialisht 3 standarde, pjesërisht 6 dhe nuk përmbushë 2 standarde.

#### **Provat e administruara:**

- Vendimi i KSHC-së Nr. 983/20D, datë 21.07.2020;
- Raporti final i ekipit të ekspertëve;
- Raporti i KSHC-së për rishqyrtimin e ankesës nga takimi i datës 02.09.2020

#### **Shpjegim i situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi**

Komisioni i Ankesave pranë AKA-së, ka pranuar ankesën nr. 1282/20H, datë 20.08.2020, e Kolegjit të Shkencave të Aplikuara Teknike “Tempulli” më datë 23.10.2020, së bashku me dokumentacionin dhe raportin e KSHC-së nga takimi i datës 02.09.2020, me të cilën ka përshkruar pretendimin e palës dhe arsyen e refuzimit të kërkesës për akreditim.

Komisioni i Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës dhe provave të bashkëngjitura ka gjetur se:

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë të angazhuar nga AKA për vlerësimin e Kolegjit të Shkencave të Aplikuara Teknike “Tempulli” nga gjithsej 11 kapituj të standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit, Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike “Tempulli” përmbushë substancialisht 3, pjesërisht 6 dhe nuk përmbushë 2. Po ashtu, ekipi i ekspertëve në fund të raportit ka rekomanduar që të mos akreditohet në nivel Institucional Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike “Tempulli”.

#### **Shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave**

Komisioni i Ankesave, pasi ka konstatuar se ankesa e Kolegjit të Shkencave të Aplikuara Teknike “Tempulli” është parashtruar brenda afatit kohor, ka shqyrtuar pretendimet e palës për mos akreditimin institucional.

Komisioni i Ankesave e ka analizuar raportin e ekspertëve ku ekspertet ndërkombëtar nuk kanë rekomanduar akreditimin në nivel institucional të Kolegjit të Shkencave të Aplikuara Teknike “Tempulli” sepse i njëjti nga gjithsej 11 kapituj të standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit, Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike “Tempulli” përmbushë substancialisht 3 standarde, pjesërisht 6 dhe nuk përmbushë 2 standarde.



## Baza ligjore e vendimit dhe arsyeja pse është e zbatueshme në rastin konkret

Bazuar në nenin 18, paragrafi 2 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, i cili përcakton se: *"Duke u bazuar në rekomandimet nga raporti i vlerësuesve të jashtëm, KSHC merr vendimin për akreditim ose mos akreditim."*

Nga kjo, mund të vërehet se nuk janë përmbushur kërkesat ligjore për përmbushjen e standardeve sipas Manualit të Akreditimit (Korrik 2018), i cili përcakton se: *"Për të marrë një vendim pozitiv për programin dhe ri-akreditimin institucional, çdo ofrues i arsimit duhet të demonstrojë të paktën një nivel të konsiderueshëm pajtueshmërie në gjykimin e përgjithshëm. Prandaj, dështimi në përmbushjen e të paktën një niveli të përgjithshëm të pajtueshmërisë përfshinë vonimin, tërheqjen, pezullimin ose mohimin e akreditimit"*

Andaj, sipas nenit 18, paragrafin 2 të UA 15/2018 për akreditimin e IAL-ve të, Komisioni i Ankesave vlerëson se deri sa KSHC merr vendim bazuar në rekomandimet nga raporti i ekspertëve të jashtëm, atëherë Vendimi nr. 982/20D, datë 21.07.2020 i KSHC-së ka bazë ligjore dhe arsyeshmëri të plotë.

Pala me datë 29.10.2020, ka qenë e ftuar nga Komisioni i Ankesave për ta ushtruar të drejtën e vet për tu dëgjuar, ashtu siç e parasheh nenin 95 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli" e ka realizuar këtë të drejtë, por nuk ka parashtruar prova dhe argumente shtesë.


Në përfundim,

Komisioni i Ankesave pasi shqyrtimit dhe administrimit të provave, vërtetimit të gjendjes faktike dhe legjislacionit në fuqi, mbi bazën e kompetencave të dhëna me nenin 22, paragrafin 3 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Komisioni i Ankesave në AKA


KA/Nr. 2904/20, datë 23/11/2020

Procesmbajtësi



Arianit Krasniqi

Kryetari i Komisionit të Ankesave



Faton Merovci



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditëve në gjykatën kompetente për konfliktet administrative.